

VENDIM
Nr.227, datë 7.4.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E INTEGRIMIT, PËR PAGESËN E KUOTËS VJETORE TË
BASHKËFINANCIMIT TË ASISTENCËS TEKNIKE, NË KUADËR TË PROGRAMIT,
IPA, BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR, ADRIATIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.10152, datë 28.9.2009 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane, për programin e bashkëpunimit ndërkufitar Adriatik, të Instrumentit të Ndihmës së Paraaderimit, IPA, komponenti II - Bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Integrimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Ministrisë së Integrimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi 4 300 000 (katër milionë e treqind mijë) lekë, për pagesën e kuotës vjetore të bashkëfinancimit të asistencës teknike, në kuadër të programit, IPA, bashkëpunimi ndërkufitar Adriatik.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit të vitit 2010.

3. Ngarkohen Ministria e Integrimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha